

Bilanci i vitit 2017 SiCRED Assistance sh.p.k.

Subjekti SiCRED Assistance sh.p.k.; është shoqëria më e hershme nga shoqëritë e regjistruara në Shqipëri me objekt, veprimtarinë e këshillimit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Përgjegjës për dhënien e këshillimit të jashtëm ndaj subjekteve tregtare me numër të punësuarish prej me shume se 1000 punëtorë, jemi munduar që gjatë vitit të mbyllur në 31 Dhjetor 2017, të ofrojmë shërbim të vazhdueshëm e me cilësi të lartë, sa i takon këshillimit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në mjediset e punës. SiCRED Assistance sh.p.k; gjatë vitit 2017, është angazhuar plotësisht për të ofruar shërbimin e konsulentit të jashtëm, në cilësinë më të mirë dhe me kostot më të ulëta të mundshme.

Viti financiar i mbyllur më 31 dhjetor 2017, për SiCRED Assistance sh.p.k., dëshmoi se shoqëria konsulente ka konsoliduar dhe përmirësuar më tej proceset me entet punëdhënëse ku jep shërbimin e konsulencës, lidhur me çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë. Ky vit shënoi vitin e parë fiskal në të cilin shoqëria realizoi fitim nga aktiviteti i saj ekonomik, ndonëse simbolik. Përgjatë periudhës 1 Janar 2017 -31 Dhjetor 2017 SiCRED Assistance sh.p.k; rriti numrin e kontratave të këshillimit për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke realizuar kështu edhe një angazhim të marre ndaj aksionareve në kuadër të zbatimit të programit të përmirësimit të aftësive e treguesve financiare të shoqërisë.

Gjatë vitit 2017 SiCRED Assistance sh.p.k., transmetoi tek entet partnere, nëpërmjet kontratave të shërbimit të konsulencës, besimin dhe përgjegjësinë, se këto shërbime janë të domosdoshme. Ato i shërbejnë për se pari dhe kryesisht, shëndetit publik e punëmarrësve e po aq dhe enteve- punëdhënëse, që me guxim përqaasën

atë që ligji imponon, “*kujdesin ndaj shëndetit dhe sigurisë së punonjësve në mjediset e punës*”.

Në mënyrë të përmbledhur në këtë bilanc për vitin 2017, shoqëria SiCRED Assistance sh.p.k., afirmon se “*Sigurimi i shëndetit dhe i sigurisë në punë i të gjithë punonjësve*”, të kontraktorëve tanë është gjithmonë një prioritet kyç dhe një përgjegjësi e madhe për SiCRED Assistance sh.p.k., e cila me rekomandimet edhe konsulencën që jep në këtë drejtim, ndihmon jo vetëm subjektet punëdhënëse për të përmirësuar standardet e punës për punëmarrësit e tyre, por ndihmon edhe në edukimin edhe informimin e publikut në këto çështje e me gjerë.

Në vitin 2017 SiCRED Assistance sh.p.k., u përshtat në dhënien e shërbimit si konsulent i jashtëm për entet e pajtuara me kontrate, në veçanërisht funksionet parësore të çështjeve të riskut në mjediset e punës. Aty ku sipas kërkesave të entit punëdhënëse, shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k., i është kërkuar përgjegjësi shtesë, në raportet dhe vëzhgimet e kryera në vend, në kemi vlerësuar ndikimet e shëndetit dhe sigurisë për çdonjërin punonjës, dhe mjedis punë, për t’u siguruar që rreziqet e identifikuar në këqyrjen në vend e që impaktojnë drejtpërdrejt punëmarrësit, të jenë kuptuar drejt nga enti punëdhënëse e të jenë menaxhuar në mënyrë efektive kërkesat për ndryshime e përmirësime, varësisht nga niveli i shkallës së rrezikut dhe bazuar në rekomandimet tona.

Gjatë vitit 2017 në kemi vazhduar të inkurajojmë punonjësit dhe kontraktorët tanë me ane të raporteve të vlerësimit të riskut që të bëjnë ndërhyrje pozitive dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për të arritur standardin ligjor, kur ekzistojnë procese, veprimtari apo kushte të pasigurta për shëndetin dhe sigurinë në punë të punëmarrësve.

Ne do të vazhdojmë të inkurajojmë raportimin e incidenteve të rëndësishme nga punëdhënësit dhe do t'i trajtojmë ato seriozisht për të siguruar që ne po mësojmë, e po nxjerrim të metat tona prej tyre, për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet që mund të ri-prezantohen në të ardhmen.

Ndonëse numri i rritur i kërkesave nga entet punëdhënëse në adresë të kërkesës për shërbime të konsulencës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, kryesisht është rritur si rrjedhojë e rritjes së kontrollit të strukturave përkatëse shtetërore, që monitorojnë çështjet e zbatimit të standardeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, performanca e aktivitetit tonë për çështjet e sigurisë ka dëshmuar përmirësime.

Gjithsesi ne nuk mund të shprehemi të vetëkënaqur, nën këto konstatime dhe nën aspiratat e një progresi pozitiv, nëse do të punojmë ditë për ditë, ne besojmë se do të vazhdojmë e do të sigurojmë që po bëjmë ndërhyrje pozitive për të parandaluar dëmtimet e të punësuarve në çdo segment e proces-punë dhe që për çështjet e rrezikut në mjediset e punës, të përfshihen e të bëhen me dije të gjithë punonjësit, pasi rreziku është i paparashikueshëm e mund t'i shfaqet beftazi çdo njeri.

Filozofia e këqyrjeve dhe vërejtjeve tona pozitiviste, është ideuar duke punuar së bashku me burimet njerëzore të enteve punëdhënëse, që ne kemi klientë, duke vlerësuar maksimalisht faktin që ky shërbim këshillimor, u mundëson menaxherëve të marrin informacion dhe këshilla për të menaxhuar shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve dhe për të mbështetur punonjësit me kushte shëndetësore sipas standardeve ligjore në afatgjatë dhe afatshkurtër.

Një falënderim të veçantë SiCRED Assistance sh.p.k.; ua adreson pikërisht ekipeve të burimeve njerëzore të enteve punëdhënëse, të cilët me guxim, vlerësim, kurajë dhe efektivitet kanë tejçuar deri në nivelet e larta hierarkike të punëdhënësve të tyre, rëndësinë e zbatimit të çështjeve të shëndetit dhe sigurisë në punë,

përkrahjen dhe përjasjen e rekomandimeve të konsulentit. Pikërisht këto struktura me përlësi dhe korrektesë gjatë gjithë vitit 2017, kanë punuar së bashku me SiCRED Assistance sh.p.k., për të mbështetur menaxherët për të përmirësuar më tej sistemin e menaxhimit dhe monitorimit të rreziqeve në mjediset e punës.

Në fokusin e SiCRED Assistance sh.p.k., në vitin pasues 2018 do të jenë çështjet e demografisë së fuqisë punëtore, të identifikimit të sfidave që shfaqin incidentat e pazakonta shëndetësore, përfshirë nevojat e punonjësve të moshuar, punonjësve me moshë të re, punonjësve me aftësi të kufizuara, po aq edhe problemet e sigurisë dhe të shëndetit të grave.

SiCRED Assistance sh.p.k., ka punuar ngushtë me partnerët e kontraktuar gjatë vitit 2017. SiCRED Assistance sh.p.k., në mënyrë efektive nëpërmjet raporteve konsultative, mbështet punonjësit e enteve punëdhënëse, të identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet potenciale shëndetësore para se të hasen probleme të shëndetit nga sëmundje profesionale apo aksidente që mund të shmangen.

Krahas komunikimeve tona në periodikë të caktuar, për çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, SiCRED Assistance sh.p.k., është angazhuar për të ndarë aspiratat e saj me fokus përmirësimin e praktikave të sigurisë dhe shëndetit në punë, pranë enteve punëdhënëse.

Të vëmendshëm ndaj rreziqeve SiCRED Assistance sh.p.k., ka pranuar rëndësinë e faktorit njeri, si kontribuues ndaj incidenteve, nën këtë kuptim, jemi fokusuar në rekomandimet e dhëna në raportet e këshillimit, pikërisht në përmirësimin e kulturës, kujdesit dhe sjelljes sonë në kryerje të proceseve të punës.

Prioritetet për vitin e ardhshëm 2018, janë për të vazhduar për të menaxhuar dhe monitoruar rreziqet e shëndetit dhe sigurisë, pranë enteve punëdhënëse dhe për të ruajtur, përmirësuar e akredituar sistemin tonë të

brendshëm të menaxhimit në çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë; duke ofruar përmirësime të mëtejshme të aktivitetit tonë, po ashtu edhe procedurat e biznesit.

Ne jemi të kënaqur për arritjet e regjistruara gjatë vitit 2017 me entet punëdhënëse për çështjet e trajtuara për shëndetin dhe sigurinë në punë. Jemi te ndërgjegjshëm dhe dimë se ka më shumë për të bërë në këtë aspekt, dhe se kjo, është tani një faktor i qartë i angazhimit të punonjësve të SiCRED Assistance sh.p.k., për të ndërtuar një model profesional, konsekuent, të shëndoshtë e të qartë të shoqërisë, pavarësisht vështirësive të këtij sektori dhe tregu.

Kjo do të vazhdojë të jetë një fushë prioritare gjatë vitit 2018, ndërsa ne i kemi organizuar planet tona të punës, drejt përmirësimit dhe drejt statusit të perfeksionimit të çështjeve që trajtojmë me përkushtim. Jemi krenare që gjatë 2017, kemi organizuar në disa subjekte trajnime mbi dhënien e ndihmës së parë në punë duke e parë këtë aspekt, si një strategji të re për të përqasur procedurat me drejtoritë e burimeve njerëzore në entet ku kemi kontrate konsulence. Ky këndvështrim shërben për të ndihmuar në fund të fundit punën tonë të përbashkët për siguri në mjediset e punës e në atë sa mundet evitim të çdo pasoje dëmtuese për shëndetin e punonjësit.

Ne jemi të përkushtuar për të ofruar strategjinë tonë gjatë vitit 2018 për shëndetin dhe sigurinë, duke mësuar edhe nga subjektet e tjera konkurrense në çështjet e Shëndetit dhe Sigurisë dhe apo ente publike që duan të përqasin në këtë industri praktikat më të mira.

Sfidat tona të vitit të ardhshëm janë të përfshihemi e të sigurojmë ekspansion më tej me planet tona në treg, për të përmirësuar dhe transmetuar kulturën pranë enteve punëdhënëse, se çështjet e sigurisë dhe shëndetit në mjediset e punës janë shumë të rëndësishme e u vlejné enteve.

Për të përmirësuar edhe përcjellë propagandën për “ndërmjetësimin” gjatë vitit 2017, SiCRED Assistance sh.p.k., ka kryer trajnim të punonjësve për çështjet e

ndërmjetësimin në punësim, ndërmjetësimin në shërbime mjekësore, kërkesave dhe standardeve që aplikon shoqëria ndërmjetëse në këtë drejtim.

Duke pasur busull arsyet etike, dhe ligjore për ndërmjetësimin në punësim dhe në shërbimet mjekësore me standarde gjatë vitit 2017 SiCRED Assistance sh.p.k., ndërtoi kontratat e para për të furnizuar klientët e saj edhe me shërbimin e ndërmjetësimin në punësim dhe ndërmjetësimin në shërbime mjekësore.

Duke pasur në vëmendje dhe një vështrim të situatës globale, lidhur me avantazhet e ndërmjetësimin në punësim e fokus përthithjen e personelit punonjës të shëndetshëm, me njohuri, aftësi dhe kualifikim të përshtatshëm për disa lloje punësimi, kemi ndërtuar një model ekonomik, për të mbështetur aktivitetin tonë, duke u mbështetur edhe në të dhëna të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH); si dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Nën faktin e pakontestueshëm se ndërmjetësimi në punësim, e ndërmjetësimi në shërbime mjekësore, po atë edhe shëndeti dhe siguria e punonjësve, janë së bashku aktivitete komplementare të SiCRED Assistance sh.p.k., ne kemi besuar dhe do të vazhdojmë të besojmë tek dhënia e shërbimit në këto aspekte. Forca aktive për punë e punonjësve, referuar statistikave publike të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), përbën pothuajse gjysmën e popullsisë globale, andaj e konsiderojmë me rëndësi të madhe, ti kushtojmë vëmendje të posaçme të tre dimensioneve të aktivitetit të SiCRED Assistance sh.p.k..

SiCRED Assistance sh.p.k.; i shikon këto tre aspekte të rëndësishme, jo vetëm për punonjësit si individë apo dhe familjet e tyre, por edhe për produktivitetin, konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e enteve punëdhënëse, e gjitha me efekt pozitiv edhe në ekonominë kombëtare. SiCRED Assistance sh.p.k.; i shikon këto çështje sa të lidhura e ndërvarura me njëra-tjetrën në nivel kombëtar, përfundimisht po atë të rëndësishme edhe në ekonominë globale.



Në buletinet zyrtare për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë të Bashkimit Evropian, theksohet se mungesa e shëndetit dhe siguria në punë, jo vetëm që kanë një dimension të konsiderueshëm njerëzor, por gjithashtu kanë një ndikim të madh e negativ në ekonomi. Kostoja e madhe ekonomike e problemeve që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë, pengon rritjen ekonomike dhe ndikon në konkurrencën ndërmjet bizneseve. Ky arsytim logjik e i mbështetur me statistika e fakte, i shërben edhe përfitueshmërisë dhe dobishmërisë së shpenzimit që kryen enti punëdhënës, për të marrë konsulencën e duhur të jashtme, pranë subjekteve me aftësi dhe cilësi e me synim evitimin maksimal të çdo aspekti dëmtes në shëndetin e punonjësve.

Referuar të dhënave të publikuara në portalin publik të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), arrijmë të përftojmë informacion të vlefshëm se sa i rëndësishëm e i domosdoshëm bëhet shërbimi i dhënë nga SiCRED Assistance sh.p.k.; në çështjet e sigurisë, shëndetit, ndërmjetësimit në punësim apo ndërmjetësimit për shërbime mjekësore cilësore.

Rezulton sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) se:

“Dy milion gra dhe burra vdesin çdo vit si pasojë e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve nga proceset e punës. Gjithaq 160 milionë raste të reja të sëmundjeve që vijnë nga puna apo të lidhura me punën regjistrohen çdo vit. Me shume se një e treta e këtyre rasteve lidhet me dhimbjen e shpinës, e shpjegohet se kanë të bëjnë me kushtet e vendit të punës; 16% e këtyre rasteve lidhet me humbjen e

dëgjimit; gati 10% e këtyre rasteve lidhet me kancerin e mushkërive; e gati 8% e këtyre rasteve lidhet me barrën e depresionit, që mund ti atribuohet rreziqeve të humbjes së vendit të punës. Numri i aksidenteve në punë që shkaktojnë tre ose më shumë ditë mungese është i madh, me mbi 7 milionë çdo vit. Megjithatë, studimet e kryera në shkallë të tjera tregojnë se rreziqet që lidhen me punën dhe problemet shëndetësore nuk shpërndahe në mënyrë të barabartë midis të gjithagrupeve”.

Sa më lart nuk janë vetëm shifra dhe fakte, SiCRED Assistance sh.p.k.; beson se po të punojmë për ditë e me besim të plotë, një dite do të kemi tregues të reduktuar, të dëmeve të shëndetit në punë e të punësuar të shëndetshëm. Ne duam që gjatë 2018 të thellohem i të modelojmë në punën tonë edhe regjistrin e shifrave të dëmtimeve, që vijnë nga puna dhe për shkak të punës edhe në ndarje, sipas gjinisë, moshës, etnisë, statusit të emigrantëve apo të dhëna të tjera demografike.

Besimplotë se është domosdoshmëri, marrja e masave për të minimizuar rreziqet që vijnë nga puna apo për shkak të punës, dhe se vëmendje të veçantë kërkon pjesa në nevojë e vulnerabël, punonjësit e rinj në moshë, punonjësit e moshuar apo punonjësit me aftësi të kufizuara, problemet e sigurisë dhe të shëndetit të grave, si dhe duke u kujdesur e pa deformuar edhe aspektin gjinor, SiCRED Assistance sh.p.k.; do të përdorë çdo energji e aftësi gjatë 2018, që çështjet e punës dhe shëndetit apo ndërmjetësimit për punë të përshtatshme, e në shërbime mjekësore cilësore, të kenë më shumë vëmendje, që çdo e dhënë e ndërvarur me këto aspekte të mos injorohet, të reflektohet saktë në çdo rekomandim këshillues, kontratë, shërbim apo hulumtim.

*Besimplotë se e ardhmja do të jetë më e mirë me punën në grup
Sinqerisht*

Vjosa BODO MUJO

Administrator

i SiCRED Assistance sh.p.k.